



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-II.-13-0389-C0001

Parashtruesi i ankesës:

A.K., Prizrenit

Kundër

Pala kundërshtare:

NSH Prizren, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Teuta Ibrahimimi më 26 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Padia në tërësi refuzohet si e pabazuar.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Më 24 shtator 2013, parashtruesi i ankesës ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër NSH "P", me seli në Prizren, e administruar nga AKP-ja kundër vendimit të AKP-së nr. 7734 të datës 12.09.2013.

Në ankesë kërkon nga Dhoma e Posaçme që të abrogojë vendimin e lartpërmendur dhe të aprovojë tri pagat në shumë prej 750 euro.

Ankuesi thekson se ka përvojë 32 vjeçare dhe se në NSH ka punuar deri në privatizimin e saj pra më 02.08.2011 me pagë mujore prej 250 euro në shumë të përgjithshme prej 750 euro e jo siç ceket në vendim 705 euro.

Në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, parashtruesi i ankesës ka dorëzuar:

- Kopjen e vërtetuar të kontratës së punës nr. 1.106/03/2003 të datës 03.03.2003;
- Kopjen e pavërtetuar të librezës së punës;

Më 30 tetor 2013, Dhoma e Posaçme ka lëshuar një urdhër për palën kundërshtare NSH , Prizren, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që të paraqesë mbrojtje në padi.

Më 13 dhjetor 2013, AKP-ja paraqet mbrojtjen e saj në Dhomën e Posaçme në të cilën thekson se parashtruesi i ankesës nuk ka qenë punëtor i Ndërmarrja Shoqërore në kohën e privatizimit dhe se në pajtim me Marrëveshjen Koncesionare në fuqi që nga 19 prill 2001, dhe NSH-ja nuk mban përgjegjësi ndaj punonjësve që nga data e hyrjes së marrëveshjes në fuqi dhe se parashtruesi nuk ka të drejtë të marrë tri pagat e fundit.

Tutje AKP-ja në mbrojtje i kërkon Gjykatës që ankesën e parashtruesit ta refuzojë si të pabazuar.

Në mbështetje të mbrojtjes së saj AKP-ja ka bashkëngjitur:

- Kopjen e vendimit për fillimin e likuidimit të NSH-së i cili kishte hyrë në fuqi më 27 qershor 2013;
- Kopjen e planit nr. 019-696 të datës 15.07.2011
- Kopjen e Deklaratës së bartjes së aseteve dhe detyrimeve të përcaktuara nr. 1929/2011 të datës 02.08.2011;
- Kopjen e Kontratës së Koncesionit;

Arsyetimi Ligjor:

Gjykata gjen se, ankuesi kërkon pagat e papaguara nga Ndërmarrja Shoqërore në Prizren kurse në bazë të provave të bashkëngjitura ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë se ka qenë punëtor aktiv i NSH-së dhe nuk ka qenë në listën e pagesave në momentin e privatizimit.

Gjykata iu referua Marrëveshjes së Komercializimit të nënshkruar nga UNMIK-ut si Koncesiondhënës me kompanitë private P.T.T dhe N.T.SH.P si fituesve të grantit, në fuqi nga data 19.04. 2001.

Për më tepër në bazë të kopjes së librezës së punës së dorëzuar nga parashtruesi i ankesës, marrëdhënien e tij të punës në Ndërmarrjen Shoqërore në Prizren ishte ndërprerë më 19.04.2001. Parashtruesi i ankesës sipas kësaj libeze kishte filluar marrëdhënien e punës në NP A në Prizren më datën 20.04.2001 dhe rezultoi të jetë e mbyllur më 02.08.2011.

Si rrjedhojë kërkesa për pagat e papaguara do të duhej t'i drejtohej bashkëpunimit privat e jo NSH-së ngase parashtruesi i ankesës nuk ishte punëtor i NSH-së.

Duke pasur parasysh provat e lartpërmendura dhe rrethanat juridike Gjykata vendosi që në tërësi të refuzojë ankesën si të pabazuar në ligj ashtu siç u tha në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, Neni 13, pika 13.3, ky ankues lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____